DALËSE-IZLAZNA OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 0204-637/2
-III-
Data Datum Date 31.05.2013

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**
**Qeveria - Vlada - Government**
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

Datë: 27.05.2013
Nr. 0204-637

**PËR:** Isni Kilaj, Kryetar i Komunës së Malishevës
Ragip Begaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Malishevës

**LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË MALISHEVËS, Nr.02/103, Pranuar me datë, 15.05.2013.**

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit Nr.02/103, të miratuar me datë 25.04.2013, ***KONFIRMON*** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale .

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Vendimi Nr.02/103, për caktimin e deponisë së mbeturinave inerte.

Me respekt,

**Slobodan Petrović,**
**Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL,-së**

**Kopje:** *Besnik Osmani, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së*
*Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së*
*Arkivit të MAPL-së.*

DALËSE - OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 0204-637/2
-III-
Data Datum Date 31.05.2013

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**
**Qeveria - Vlada - Government**
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

Datum: 27.05.2013
br. 0204-637

**Za:** Isni Kilaj, Gradonačelnik opštine Mališevo
Ragip Begaj, Predsedavajući Skupštine opštine Mališevo

**Predmet:Potvrda zakonitosti odluke opštine Mališevo, br.02/103, Primljeno dana , 15.05.2013.**

Poštovani/e

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa njenim mandatom, definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-04, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim adminstativnim oblastima kancelarije Premijera i Ministarstva nakon razmatranja odluke br.02/103, odobreno dana 25.04.2013, POTVRĐUJE zakonitost ovog akta i procenjuje da je isti taj u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi .

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je , kao što sledi,

- Odluka br.02/103, o postavljanju deponije inertnog otpada.

Sa poštovanjem,

**Slobodan Petrović,**
**Zamenik premijera i Ministar MALS-a,**

**Kopije:** *Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a*
*Rukovodiocima odeljenja MALS-a*
*Arhivi MALS-a.*

PRANUAR NË:
ACCEPTED ON: 14. 05. 2013

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministry of Local Government Administration
Datum / Date: 15. 05. 2013

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi i Komunës
Nr. 02/____
Datë: 14. 05. 2013

Në pajtim me nenin 11, 12.2 shkronja (d) nenin 13, 17 shkronja (f), neni 58 shkronja (g) të Ligjit për Vetëqeverisjen lokale, Ligji nr.03/L-040, si dhe mbështetur në nenin 30 të Statutit të Komunës së Malishevës.

***Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur me datë, 25.04.2013 mori këtë;***

# VENDIM
## PËR CAKTIMIN E DEPONISË SË MBETURINAVE INERTE

Neni 1

Miratohet, Propozim – vendimi i Kryetarit të Komunës nr. 01/462 datë 16.04.2013, për caktimin e Deponisë së mbeturinave inerte në ish lokacionin e shfrytëzuar nga Miniera e Boksideve në mes të fshatrave Panorc dhe Llapçevë, Komuna e Malishevës.

Neni 2

Lokacioni sipas pikës 1 të këtij vendimi është përcaktuar në pjesën e ngastrës kadastrale nr. P-72310064-00573-1, e evidentuar sipas fletës poseduese nr.114, në emër të OTHPB, Ekonomia e Pyjeve Z.K. në Panorc, në vendin e quajtur Grab. Caktimin e sipërfaqes brenda këtij lokacioni obligohen ta përcaktojnë, drejtoria për Gjeodezi, kadastër dhe shërbim Pronësoro Juridik, përmes drejtorisë për Urbanizëm.

Neni 3

Ky vendim obligon të gjithë qytetarët dhe bizneset që mbetjet inerte të dërgohen në këtë deponi dhe në asnjë vend tjetër.

Neni 4

Ky vendim përjashtohet për rastet kur qytetarët apo bizneset me vendim të Komunës (Drejtorisë për Urbanizëm), për nevoja të tyre apo të personave të tjerë, ipet leje e veçantë.

Neni 5

Mosrespektimi i këtij vendimi do të ketë për pasojë gjobitjen e personave apo bizneseve që ndotin ambientin dhe hedhin mbetje në pronën publike dhe private dhe atë për një karrocë me mbetje inerte 100 euro, për një rimorkio 500 euro dhe një kamionet mbi 3 ton 1000 euro.

21-05 2013

Neni 6

Mbikëqyrja e Deponisë do të bëhet nga Ndërmarrja Publike " Eko-Regjioni", njësia në Malishevë

Neni 7

Zbatimi i gjobave dhe dënimeve bëhet sipas ligjeve dhe procedurave ligjore që janë në fuqi në Republikën e Kosovës.

Neni 8

Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjë, Kryetari i Komunës përmes organeve kompetente.

Neni 9

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Malishevës.

Vendimi u dërgohet;
MAPL-së,
Drejtorive përkatëse,
Arkivit

Kryesuesi i Kuvendit
Rapip Begaj